

# Mundësitë për gratë e papunësuar në Maqedoni

## Dokumentacioni i proektit për pregatitje



Project funded by the European Union

“Përmirësim i gjasave për punësim të grave nga komunitetet pakicë  
përmes profilimit/vlerësimit, programeve për stërvitje dhe këshillimit  
për punë”

## Imprint:

Publisher:  
Internationaler Bund (IB) e.V.  
Verbund Württemberg  
Heusteigstr. 90-92  
70180 Stuttgart  
Germany  
Phone +49711 6454-412  
Fax +49711 6454-589  
Internet:  
[www.internationaler-bund.de](http://www.internationaler-bund.de)  
Project website: [www.quali4women.org](http://www.quali4women.org)

This handbook is available in Macedonian, English, Roma, Albanian and Turkish.

Project Manager: Gabriela Maraha

Pictures: Internationaler Bund, Derya, Irhom Topaana, Women's Forum

April 2014

*“Ky punim është shtypur me ndihmën e Bashkimit European. Përmbajtja e këtij punimi është përgjegjësi e vetme e Internationaler Bund e.V., Derya, Irhom Topaana dhe Forumi i Grave dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit European.”*

*Projekti “Për përmirësim të Punësimit të Grave të Komuniteteve Pakicë përmes profilimit/vlerësimit, programeve për stërvitje dhe këshillimit për punë” (MGPM), me numër kontrate 09-38047/1, e themeluar nga Bashkimi European në suaza të kornizës së Programit Operativ për Menaxhim të Burimeve Njerëzore 2007-2013 (IPA Component IV.)*



## Përmbajtja

|                                                |    |
|------------------------------------------------|----|
| Projekti dhe Konceptet e tij                   | 4  |
| Organizatrat për zbatim                        | 6  |
| Aktivitetet e Projektit                        | 9  |
| Kurset për stërvitje në Shkup                  | 10 |
| Kurset për Stërvitje në Tetovë                 | 13 |
| Kurset për stërvitje në Radovich               | 14 |
| Programi për përkrahje edukative               | 15 |
| Kursi për biznes                               | 16 |
| Përcjellja e njohurive                         | 18 |
| PGKM fakte dhe shifra                          | 19 |
| Rezultate dhe reagimi nga target grupa         | 20 |
| Sugjerime për mbajtjen e kurseve për stërvitje | 22 |
| Të aplikuarit për fonde të Bashkimit European  | 24 |

# Projekti dhe Konceptet e tij



## Për ç'bëhet fjalë?

MGPM qëndron për "Për përmirësim të Punësimit të Grave të Komuniteteve Pakicë përmes profilimit/vlerësimit, programeve për stërvitje dhe këshillimit për punë ". Ky projekt është finansuar nga Programi Operativ për Menaxhim të Burimeve Njerëzore 2007-2013 (IPA Component IV) dhe ka për qëllim përmirësimin e punësimit të grave nga komunitetet pakicë në Maqedoni. Ky projekt është nisur në Nëntor 2012 në periudhë prej 17 muajsh.

## Cilat janë synimet?

Ky projekt ka dy synime, të cilat janë të ndërlidhura mes vete : Synimi kryesor është që të përmirësohet punësimi i grave nga komunitetet pakicë në Maqedoni përmes dhënies shans për stërvitje profesionale. Synimi tjetër ka të bëjë me ndërtimin e kapaciteteve të tre organizatave partnere dhe përkrahja e të njëjtave me zgjerimin e aktiviteteve të tyre për të ndihmuar gratë e kategorive të cënueshme të popullatës së Shkupit dhe rrethinës së Tetovës dhe Radovishit duke zgjidhur problemin e papunësisë. Kursi për stërvitje kontribuon për integrimin social dhe ekonomik si dhe për përmirësimin e kushteve për jetesë të pjesëmarrësve. Këto gra i rikthehen sistemit edukativ përmes kurseve për stërvitje të cilat rrisin aftësinë konkurruese në tregun e punës dhe gjasat për punësim në sektorin publik dhe privat.

## Konteksti

Aktivitetet përqëndrohen tek minoritetet etnike siç janë gratë Turke, Rome, Sërbe, Boshnjake si dhe ato Shqiptare. Ideja e këtij projekti u paraqit si nevojë për të pasur njerëz më të arsimuar në mes të komuniteteve etnike. Shumë njerëz nga komunitetet më të vogla etnike kanë lënë shkollimin qysh herët. Shkakët për këtë kanë të bëjnë nga pozita e ulët në shoqëri, kulturë dhe traditë si dhe nga niveli i ulët i vetëdijes në të kaluarën. Në Maqedoni, gratë në përgjithësi kanë gjasa të ulëta në tregun e punës dhe shumë pak qasje për një stërvitje profesionale. Shkak i pagave të ulëta në përgjithësi në krahasim me shtetet tjera Europiane, gratë kanë nevojë për burim page me qëllim që të mbajnë veten dhe/ose familjen e tyre. Problemet specifike që trajtohen në këtë aktivitet janë shkalla e lartë e papunësisë dhe niveli i ulët i punësimit i grave nga komunitetet etnike, mungesa e stërvitjes profesionale, qasja dhe mundësitë për stërvitje profesionale për të rriturit, mungesa e informatave për gjendjen ekonomike dhe të drejtat e qytetarit dhe ligji i punës si dhe roli i dobët në përgjithësi i grave në publik në shoqërinë civile. Tre organizatat për zbatim kanë punuar me gra nga komunitetet etnike për vite me rradhë. Ata besojnë në kapacitetet dhe aftësitë e këtyre grave.

## Një sy mbi aktivitetet e projektit

Aktivitetet e projektit janë dizenuar me qëllim përfshirjen e gruas në tregun e punës si dhe përkrahjen e tyre në sipërmarrje në kushte afatgjate. Partneriteti ka identifikuar strategjinë e të stërviturit të orientuar sipas nevojave të cilat kualifikojnë dhe pregatisin gratë nga pakicat etnike për sistemimin e tyre në tregun e punës ose për krijim e biznesit të tyre personal. Grave pjesëmarrëse u është ofruar profilim/vlerësim me mundësi pasuese të stërvitjes profesionale të cilat mbulojnë nevojat dhe kërkesat e tyre. Gratë kanë fituar ekspertizë profesionale në fushat e përveçme përmes kurseve të stërvitjes. Kurset përkrahëse si në fillim ashtu edhe në fund për synim kishin vetëdijësimin e tyre si dhe përkrahjen e tyre për të gjetur punë. Gjatë këtyre javëve përkrahëse edukative, gratë gjithashtu kuptuan për të drejtat e tyre rtë punës dhe civile si dhe mënyrat dhe mundësitë e tyre për të luajtur rol aktiv në shoqëri. Mundësitë e stërvitjes ishin të strukturuar në atë mënyrë që gratë e pakicave etnike të mundën lirshëm të marrin pjesë. Kujdesi për fëmijë ofrohej përgjatë gjithë kursit.



Majtas lart: Fustan i qepur në mënyrë tradicionale gjatë kursit për qendisje në Radovish  
Djathtas lart: Kurset për kompjutor në Topaanë  
Në mes: Pjesëmarrëse me veshje tradicionale në Radovish  
Poshtë majtas: Pjesëmarrëse në Tetovë me Çertifikatë  
Poshtë djathtas: Duke mësuar për procedurat e aplikimit në Topaanë

## Organizatat për zbatim

Projekti u zhvillua në formë partneriteti mes organizatave Gjermane dhe Maqedonase. Partnerite i projektit u udhëhoq nga German Internationaler Bund e.V. dhe përbëhej nga partnerë me përvojë projektsh të cilët punojnë me gra nga pakica të ndryshme në Maqedoni: Derya kryesiht me Turq, Forumi i gruas me Shqipëtarë dhe Irhom Topaana me gra Rome. Që të katër organizatat ishin të kyçura në mënyrë aktive në zhvillimin dhe zbatimin e projektit. Menaxhimi i organizatave lokale gjente përkrahje në atë mënyrë që të luante rolin e partnerit të autoriteteve shtetërore dhe të shërbente si furnizues i shërbimeve alternative. Gjithashtu, menaxhmenti i qendrave për stërvitje ofronte ndihmë në kontrollimin dhe mirëmbajtjen e institucioneve stërvitëse. Projekti vëzhgohej nga Autoriteti Kontraktues, Ministria e Finansave të Maqedonisë, dhe Ministria e Punës dhe politikës Sociale.



**Internationaler Bund (IB) e.V. - Verbund Wuerttemberg** bën pjesë në Internationaler Bund e cila është një nga organizatat më mëdha joprotabile në Gjermani për stërvitje, punë rinore dhe punë sociale. Ka më shumë se 700 qendra dhe njësi në më shumë se 300 vende përreth gjithë Gjermanisë.

Aktivitetet kryesore të IB Wuerttemberg kanë të bëjnë me një program të stërmadh për stërvitje profesionale për njerëz me nevoja të posaçme, këshillim në karrierë dhe të rritur si dhe për grupe të marginalizuara dhe imigrantë. Përveç kësaj, aktivitetet ngërthejnë promovimin e integritit social përmes orientimit profesional, stërvitjes dhe edukimit të mëtutjeshëm.

Fushat kryesore të përqendrimit në stërvitjen profesionale janë më shumë se 30 profesione. Gjithashtu, këtu bën pjesë rehabilitimi, orientimi profesional dhe klasa e stërvitjes. IB gjithashtu ofron stërvitje jashtë punës, përkrahje stërvitore, ri-stërvitje, edukim të mëtutjeshëm, shtëpi strehuese dhe këshillim. Fushat tjera të aktiviteteve janë projektet për krijimin e vendeve të punës, shërbime sociale (ounë sociale volontere) dhe koordinimi me projektet ndërkombëtare edukative.

Për shumë vite IB Wuerttemberg ka bërë projekte ndërkombëtare edukative me partnerë nga të gjitha shtetet anëmbanë botës. Dituritë në menaxhimin e projektit dhe strategjitë për bashkëpunim global mundësojnë që i njëjtë të zhvillohet në mënyrë fleksibile dhe me besueshmëri në fushën e punës të projekteve ndërkombëtare edukative. IB Wuerttemberg kryen projekte të ndryshme me një sërë organizatash partnere anëmbanë Europës dhe botës. Me ndihmën e këtyre projekteve, jepet ndihmë qendrave për stërvitje dhe shpirti krijues zhvillohet dhe ofrohet gjatë stërvitje dhe kualifikimeve.

Për më shumë vizitoni [www.internationaler-bund.de](http://www.internationaler-bund.de)



**Organizata e grave Turke “Derya”** është organizatë joqeveritare, multikulturore, jopfitabile në Republikën e Maqedonisë. Derza është themeluar në Shkup në 1999 me qëllim që të incion aktivitete të orientuara për përmirësimin dhe përfshirjen e grave në shoqërinë Maqedonase. Derza ka më se 300 vullnetarë nga shumë etnikume dhe fe të ndryshme.

Synimi parimor i “Derya”s është që të definojë të drejtat e grave, të respekton zërin e tyre, të inicon emancipimin, si dhe të mundëson integrimin e fplotë në çdo grupim shoqëror, si dhe edukimin në lëndë të ndryshme, si medicinë dhe shëndetësi, demokraci, forcimi i shoqërisë civile, zgjidhja e konflikteve etj.

Projektet e Deryas janë të orientuara kah edukimi, përkrahja dhe nxitja e grave në luftën për pjesëmarrjen e tyre në politikë, të drejtat e grave dhe njerëzve, barazia gjinore, edukimi në shëndetësi, pjesëmarrja e barabartë e burrave dhe grave në proceset vendim marrëse.

Aktivitetet e Deryas kryesisht kanë të bëjnë me organizimin e punishteve për edukimin e grave, vetëdijësimin e tyre për barazinë gjinore dhe për ripërtirje të besimit të tyre në marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe ndëretnike si dhe toleranca.

#### **Suzana Musli, Drejtoresha ekzekutive e Deryas**



*“Ky projekt ishte një shansë i mirë për përforcimin e burimeve njerëzore të OJQ-së sonë. Jam krenare dhe e lumtur që ia dola me zbatimin e një projekti të këtillë në Republikën e Maqedonisë. Tani ne kemi forcën dhe kapacitetin për të punuar në projekte të këtilla edhe në të ardhmen. Ky projekt ishte shumë i rëndësishëm për komunitetin turk që jeton në Maqedoni dhe OTWM Derya është e para OJQ me sfond turk që zbatoi IPA IV Component Project.”*





**Forumi i grave Tetovë (FG)** është asociacion joqeveritar, apolitic, joprofitabil dhe humanitar i themeluar në Janar 2001 në Tetovë. Synimi kryesor është promovimi i grave si persona me aftësi të barabarta në vendim marrje dhe kontributi për përmirësimin e grave me qëllim që të merr vendime të rëndësishme në zhvillimin e shoqërisë civile në Maqedoni.

Forumi i Grave në Tetovë fokusohet në emancipimin e grave, sidomos të atyre nga vendet rurale, duke vetëdijësuar ato për statusin e tyre jo të barabartë në shoqëri, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe barazia gjinore. FG kontribuon në vetëdijësimin e grave për pavarësinë e tyre dhe përforcimin e vetëdijësimit të tyre për një integritet pakufi në shoqëri.

FG gjendet në Tetovë, por gjithashtu ka aktivitete në vendet veriore dhe perëndimore të Maqedonisë. Ka rreth gjashtëdhjetë anëtarë të cilët në mënyrë aktive janë të përfshirë në aktivitetet e organizatës. Antarët e FGsë kanë përvoja në punën e tyre me gra dhe fëmijë. Ata kanë marrë pjesë dhe kanë punuar në shumë seminare dhe projekte që kanë të bëjnë me edukimin e grave dhe fëmijëve.



**Asociacioni qytetar "Irhom Topaana"** ka për mision vetëdijësimin për rëndësinë e arsimit mes popullatës Rome në Shkup, të përkrahë integritetin social të fëmijë me zhvillim të kufizuar si dhe të luftojë paragjykimet për trajtim të pabarabartë.

Irhomi ka themeluar qendër falas për stërvitje në mes të Romëve në Topaana në Shkup e cila është bërë pikë e vizituar shpesh për fëmijët dhe gratë bashkë.

Synimi i Irhomit ka të bëjë me vetëdijësimin e familjeve të pafat Rome në shoqëri për rëndësinë e arsimit dhe të arrijë jo vetëm në mënyrë deklarative por edhe kushtetuese trajtimin e barabartë të fëmijëve Romë.

Aktivitet kryesorë fokusohen për ndihmimin e fëmijëve ROMë të pafat në procesin e tyre edukativ. Për këtë qëllim Irhomi zbaton projektin "Krah për Krah" përmes 80 fëmijë nga shkolla fillore dhe ajo parashkollore në bazë ditore vizitojnë qendrat për stërvitje falas. Këtu fëmijët nga familjet e pafat kanë mundësinë që të fitojnë ndihmë nga edukatorët e diplomuar të cilët i ndihmojnë ata me problemet me të cilat ballafaqohen çdo ditë. Irhomi gjithashtu përpiqet që ti rrikthejë gratë në sistemin edukativo arsimor përsëri.



## Aktivitetet e Projektit

Aktiviteti kryesor i projektit të PKGM'së është t'u ofrohet grave të papunësuar nga pakicat stërvitje profesionale në profesionet relevante në tregun e punës si kompjutori, qepje/rrobaqepësi, qëndisje, floktari, amvisëri/gatim si dhe kurse gjuhësh në Maqedonisht (letrare), Shqip dhe Turqisht. Kjo kërkonte pajisjen e klasave për stërvitje dhe përpilimin e materialit stërvitor, programin dhe praktikën më të mira për dokumentim si dhe përfshirjen dhe stërvitjen e mësuesve. Tre organizatat partnere në Maqedoni u stërvitën nga IB që të përbushin detyrat në mënyrë profesionale dhe efikase.

Kurset në Shkup, Radovish dhe Tetovë ishin falas për pjesëmarrësit. Ç'do kurs zgjate 12 javë dhe kombinohej me program për përkrahje edukative gjatë së cilës gratë fitonin aftësi të reja dhe kompetenca, merrnin informata për tema si vetëpunësimi, të drejtat civile, ligji për punë, dhuna familjare, formalitetet gjatë aplikimit etj. Gjatë përfundimit të dy kurseve, gratë kishin mundësinë për të vizituar kursin për zhvillim biznesi.

Gratë pjesëmarrëse së pari kaluan profilimin, që të vërtetoheshin aftësitë e tyre individuale dhe niveli i arsimimit. Pas kësaj bëhej e mundur që të zhvillohej plan personal sipas kompetencave të tyre dhe interesave. Duke u bazuar në këtë plan kryhej orientimi adekuat profesional dhe karrikerik për çdo grua. Që të sigurohej pjesëmarrja e rregullt e grave, kujdesi për fëmijë ofrohej.

Shumica e pjesëmarrësve preferonin punën e dorës dhe kurset për kompjutor pasi që certifikatat për punë dore si ato për qëndisje dhe floktari dhe njohuri kompjuterike dukshëm e përforconin konkurrencën e grave të papunësuar në tregun e punës. Profesionet e punës së dorës si floktaria janë profesione të famshme sidomos për ato që kanë në plan vetë punësimin. Industria e tekstilit është dega më e përhapur në ekonominë e Maqedonisë me 2.4% pjesëmarrje në PBB. Ajo luan një rol kyç në ekonominë dhe mirëqenien e shumë regjioneve në Maqedoni. Sipas të dhënave të fundit strukturale, në 2011 ka pasur 800 kompani që punësonin më shumë se 40000 njerëz që është 35% i punësimit në industri. Mundësitë për të rriturit që të vazhdojnë arsimimin në këto sektorë gjithsesi janë shumë të rralla

### **Hirisha Rexhepi, Stërvitëse në Kursin për Qepje dhe Imrane Salihi, Stërvitëse në Kursin për floktari në Tetovë**

*"Pjesëmarrësit shfaqën interes të madh dhe motiv për punë. Ata rregullisht mirrnin pjesë në kurs. Ajo që na kënaq neve më shumë është siksesi dhe arritjet e tyre përgjatë tre muajve. Gratë demonstuan një nivel të lartë të përkushtimit, mirëkuptimit dhe motivimit gjatë detyrave të tyre gjatë kursit. Numri i pamjaftueshëm i makinave ishte një pengesë për gratë që të mbaronin detyrat në kohë. Shumica prej tyre janë të interesuara që të ndjekin dhe kurse tjera."*

## Kurse për stërvitje profesionale

### Kurset për stërvitje në Shkup

Dy qendra për stërvitje janë themeluar në Shkup, njëra nga të cilat vendndodhet në anën e Romëve në Topaanë. Kërkesa për stërvitje në korniza të projektit tejkalon arritjet. Gratë filluan të marrin pjesë në kurset stërvitore disa muaj para se të fillojë.

Shumica e kurseve ër stërvitje tejkaluan numrin e 10 pjesëmarrësve. Kursi për stërvitje profesionale në Derya në komunën e Çairit ishte shumë heterogjen sa i përket bekgraundit etnik të grave.

34 Pjesëmarrëse

Boshnjake, 33 Shqiptare,

22 (Shumica Muslimane)

Maqedonase, 16 Turke

dhe 2 Vllehe.

92 gra e mbaruan 2

qendrisjen dhe rrobaqepës-

inë 3 gjuhën Shqipe 1 gju-

hën Turke 4 kursin për

kompjutorë

Sektori ekonomik në Shkup ka mungesë personeli që flet gjuhë të ndryshme të cilat janë prezente në Maqedoni. Kompanitë Turke u japin përparësi njerëzve me prejardhje Turke. Sektori i shëndetësisë ka nevojë për personel që flet shqip me klientët shqiptarë. Atësitë IT nevojiten në shumë profesione, por shumë nga gratë e pakicave kanë njohuri të pakta në ato lëmi. Andaj Derya fokusohet në aftësimin për gjuhë dhe kurse kompjutorike. Edhe pse kurset për punë dore dolën që të jenë shumë të suksesshme sidomos për punisimin e grave, kapacitetet për tëmbajtur kurse për qëndisje dhe floktari janë të kufizuara. Gjatë periudhës së parë të kursit dy kurse të gjuhës Shqipe u mbajtën. Një nga to u ndërrua në periudhën e dytë në kurs për gjuhën Turke, pasi që Derza mori shumë kërkesa për kurs në gjuhën Turke.

**Marjana Gjorgjekska, menaxhere për stërvitje Derya:**

*“Në fillim të projektit menaxherët e projektit kaluan një periudhë të rëndë: Mënyrë e re e arkivimit dhe procedurat e tenderit e bënë punën tonë të vështirë. Edhe pse kemi pasur disa përvoja të rënda me këto procedura, ne së shpejti e kuptuam se këto procese në IPA IV projektet janë të ndryshme. Sidoqoftë, ne përsëri ia dolëm të menaxhojmë këto ndryshime. Në bashkëbisedim me gratë dhe gëzimin që e pamë në sytë e tyre ajo ishte motivim i madh për mua që të ballafaqohem dhe të zgjidh këto pengesa. Ne ia dolëm! E zbatuam etapën e dytë të kurseve profesionale në tetë vendodhje të ndryshme. Numri i grave të interesuara ishte gjithmonë në rritje e sipër dhe kjo ishte një shenjë për suksesin tonë.*

*Ne kemi patur sukses që tu ndihmojmë shumë grave. Shumë gra asnjëherë nuk kanë vizituar kurse të këtilla më parë ; të tjera nuk dilnin përveç se në treg, shumë gra ishin në depresion në lidhje me gjendjen e tyre në jetë. Ne u kënaqëm së bashkë dhe mësuam nga njëra tjetra. U bëmë si një familje e madhe. ”*



Sewing & Tailoring Course in Skopje



Computer Course in Skopje



Participants of and trainers of computer courses in Skopje



A process of tailoring in Topaana:

- (1) marking the cuts...
- (2) ... cutting ...
- (3) ... sewing ...
- (4) ... finally enjoying the result!

**TOPAANA** është një lagje Rome. Kurset për stërvitje mbaheshin në zemër të Topaanës ku Irhomi i ka zyrat kryesore dhe mban vende për stërvitje për fëmijë dhe gra. Gratë nga Shuto Orizara, një lagje e madhe Rome në Shkup, gjithashtu kishin të drejtë të merrnin pjesë. Komunitateti Rom në Topaanë dhe Shuto Orizari përjetojnë papunësi dhe varfëri të madhe. Mungesa e arsimit mes Romëve e pengon jo vetëm mundësinë për punësim por edhe vetëdijësimin e tyre për të drejtat në shëndetësi dhe atë të njeriut. Veç kësaj, shumë Romë kanë pak dokumente personale, duke penguar aksesin e tyre drejt shërbimeve themelore dhe bazike.

Rreth 25% e Romëve me moshë mbi 25 janë analfabetë. Mungesa e arsimit ndikon gratë posaçërisht shkaku i rolit të tyre në familje si kujdestare që të kujdesen për vete dhe familjet e tyre. Kurset dhe shërbimet e përkrahjes në Topaanë fokusoheshin për t'iu përgjigjur këtyre pengesave: Irhomi përmbushi katër kurse për shkrim lexim në gjuhën Maqedonase, dy për qepje dhe rrobaqepësi dhe katër tjera për kompjuter.

**Silvana Matilovska, Stërvitëse në Kursin për shkrim lexim në Topaana:** *“Qëllimi i kurseve për shkrim lexim ishte që ti nxisë gratë që të vazhdojnë procesin e tyre edukativ. Gratë mësuan alfabetin, të lexuarit dhe njehsimet themelore në matematikë. Programi i kursit u dizajnua ashtu, që gratë të jenë të afta të vizitojnë institucionet vetë, tregjet, spitalet etj. Pas mbarimit të kursit çdo pjesëmarrëse fitonte certifikatë. Progresi i çdo pjesëmarrëse dokumentohej në një dosje personale”.*

**Samir Mustafa, Menaxher Stërvitës në Irhom Topaana:** *“OJQja jonë ishte e para që morri pjesë në një projekt të BE-së në kornizën të IPA IV. Për mua ky ishte një sukses real, sepse edhe në Topaanë edhe në Shuto Orizare ishte i pari. Në fillim ishte vështirë për në pasiqë duhej të mësoheshin procedurat menaxheriale. Në fund ne i përforcuam kapacitetet e burimeve njerëzore në OJQ . Gratë ishin të interesuara në kurset tona. Kemi një numër të madh grash që duan të marrin pjesë në kurset tona. Duhet ta them, se kemi bërë një punë të paqme! U kemi ndihmuar grave që të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe kapacitetet në fusha të ndryshme. Ata janë vetëdijësuar për rëndësinë e arsimit dhe punës.”*





## Kurset për Stërvitje në Tetovë

Gjithsej, 130 gra kanë mbaruar kursin për stërvitje profesionale në Tetovë. Kërkesa për kurset në fuqat e qepjes, rrobaqepësisë dhe qëndisjes ishte e madhe. Format moderne të rrobaqepësisë si dhe thurjes tradicionale, thurjes me grap dhe qëndisjes mësoheshin gjatë këtyre kurseve. Flokëtaria dhe kurset për kompjutorë gjithashtu ndiqeshin. Në krahasim, kursi për amvisëri ishte më pak joshës. Në fazën e dytë ky kurs ishte ndërruar me kursin për gatim që mbahej në një restorant lokal. Kursi për amvisëri, kompjutor dhe gatim mbaheshin në Tetovë. Flokëtaria, qëndisje dhe qepja mbaheshin në fshatrat rreth Tetovës (Tearcë, Preshovcë, Dobroshtë dhe Shipkovicë), pasi që udhëtimi çdo ditë ishte i shtrenjtë dhe lodhës për gratë që kishin obligime në shtëpi. Të gjitha pjesëmarrëset në Tetovë ishin me origjinë Shqiptare, duke bërë kështu shumicën e popullatës në Tetovë.

Në total, një kurs për qepje u krye në Dobroshtë dhe një në Tearcë, një kurs për floktari në fshatin Dobroshtë dhe një tjetër në fshatin Preshovcë, dy kurse për qëndisje në fshatin Shipkovicë, një kurs për amvisëri, një kurs për gatim dhe dy kurse për kompjutorë në Tetovë. 11 gra në Tetovë veç më kanë gjetur punë të rregullt, 19 gra janë vetë punësuar dhe 21 gra kanë në plan të hapin biznes privat.



Top: Cooking Course

Bottom: Hairdressing course

**Ardita Muaremi, Menaxher Stërvitës në Tetovo:** “Ky projekt ishte përvojë e veçantë! Në fillim kisha probleme me dokumentimin, sepse dokumentet e BE-së janë të ndryshme me ato të projektit që duhej të zbatohen më parë. Por dalë ngadalë u mësua me praktikën e re. Kurset për rrobaqepësi, kursi për floktari dhe kursi për gatim tërhoqën vëmendje, me më pak interes ishte ai për amvisëri. .

Ne do të vazhdojmë që tu japim grave informata dhe përkrahje për përfshirjen e tyre në tregun e punës, ashtu që do të kontaktohen derisa të gjejnë punë. Pa dyshim kërkesa e madhe për pjesëmarrje në këtë kurs i vetëdijësoi gratë për përfshirje në tregun e punës. . Ishtim të befasuara se sa gra kishin interes për kurset për biznes. Pasi mbaruan kurset për biznes, e pamë se mundësitë për punësim janë rritur dukshëm. Në veçanti, do kisha dashur që të potencoj bashkpunimin e mirë me IB, sepse ata ju përgjigjen kërkesave tona në çdo moment dhe u mundësojnë që të gjej zgjidhje për çdo problem. Gjithashtu Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ishin gjithmonë të gatshme që të na udhëzojnë në rrugën e drejtë.”

## Kurset për stërvitje në Radovish

Kurset për stërvitje në Radovish mbaheshin nga Derya dhe ishin kryesisht të fokusuar në popullatën Joruke Turke në Radovish. Jorukët edhe sot e kësaj dite paraqiten si segment i veçantë në popullatën e Maqedonisë dhe Thrakisë ku ata u vendosën në fillim të shek 14. Edhe pse Joprukët sot kryesisht janë të vendosur, shumë prej tyre vazhdojnë që të mbajnë traditën e

tyre nomadike dhe stilin e jetës tradicional në vendet rurale në Maedoni. Shërbimet jipeshin vizavi kërkesave të grave duke marrë parasysh stilin e tyre të jetës. Arti i qëndisjes tradicionale ishte pjesë e kurseve tona për qepje dhe qëndisje të cilat mbaheshin në fshatrat Përnali dhe Koxhali. Turqit Jorukë akoma e mbajnë traditën dhe koloritin e veshjes me thurrije të ndërlikuar. Kërkesa për profesionale që do zotëronin këtë zanat gjithashtu ishte i madh. Dy kurset tjera për po të njëjtat mbaheshin në Radovish. Në dy kurset për floktari mbaheshin në studion për floktari në Radovish nga pronari dhe stilisti i po të njëjtës. 92 gra u shpërblyen me çertifikatë për stërvitje profesionale gjatë evenimentit në komunën e Radovishit. Disa gra tani më veç aplikojnë për punë në fabrikën e sapo ndërtuar për tekstil në Radovish.



Samples of embroidery made by women in Radoviš

### Slagana Sokolova, Menaxher Stërvtës në Radovish

*“Në fillim të stërvitjes në Radovish, interesi i pjesëmarrësve ishte shumë i vogël dhe pjesëmarrja nuk ishte shumë e lartë. Por pas disa orëve interesi u rrit dhe një pjesëmarrëse e re deshte që të merr pjesë në stërvitje.*


*Kurset për qëndisje ishin më të popullarizuarat, shkaku i zhvillimit të shpejtë të industrisë së tekstilit në Radovish. Pjesëmarrëset tona mësuuan shumë shpejt dhe shfaqën interes për qëndisje. Kurset konsideroheshin si shans që të fitojnë aftësi të reja për punë. Në fund të stërvitjes, çdo grua ishte e aftë që të qepte një fustan vetë. Kjo çoi deri te interesi masiv i grave në qytet. Ne akoma pranojmë kërkesa nga gratë që vijnë në zyrat tona dhe pyesin për mundësitë e reja për stërvitje”.*

Shenaz Dervisheva, Stërvitëse në kursin për Rrobaqepësi në Koxhali

*“Zakonisht gratë nga fshatra të tilla punojnë çdo ditë dhe nuk kanë jetë sociale. Kurset profesionale kontribuojnë për përfshirjen sociale të Turqve Jorukë në fshatrat e Radovishit. Më duhet ta qartësoj se burrat na ndihmuan shumë në mbajtjen e kurseve”.*

## Programi për përkrahje edukative

Shërbimet për përkrahje edukative formojnë pjesë integrale të kursit. Gjatë çdo etape të kursit dy javë janë posaçërisht të përpiluara me një program për përkrahje edukative. Me këtë synohet që të vetëdijësoheshin gratë, duke përkrahur ata në futjen e tyre në tregun e punës gjë që çonte drejt mundësive. Pjesëmarrëset tona mund të zgjidhni disa nga punishtet interaktive dhe



Women in Skopje learn to create their CV

të orientuara kah anëtarët dhe/ose ligjeratave. Programi për përkrahje edukative u ofrohej edhe grave tjera të interesuara që të përfshihej familja dhe komuniteti në aktivitetet e projektit. Gjatë projektit ky program u bë mjaft i famshëm. Shumë të jashtëm e shfrytëzuan mundësinë që të vizitonin qendrat për stërvitje dhe të kuptonin më shumë rreth stërvitjes dhe shërbimeve që ofroheshin. Më shumë se 500 pjesëmarrëse ishin të regjistruara në listë.

Ky program në të tre qytetet përfshinte punishte dhe ligjerata për përmirësimin ekonomik të grave, edukimit shëndetësor, mbrojtjes së grave nga kanceri dhe të drejtat e grave. Java e fundit e përkrahje edukative e çdo kursi përdorej që të përmirësoheshin njohuritë e grave për procedurat e aplikimit si dhe në pregaditjen e tyre për përpilimin e një aplikimi. E-mail adresa u hapën për çdo anëtare. Gratë mund të pregadisnin CV-të e tyre sipas standartit Europas dhe ata mësuan se si të kërkojnë punë në internet.



## Kursi për biznes

Gjatë mbarimit të kurseve për stërvitje profesionale, kurset për biznes mbaheshin në qendrat për stërvitje në Shkup, Radovish dhe Tetovë. Gratë anëtare stërviteshin nga specialistë për principet themelore sesi duhet themeluar dhe udhëhequr një biznes. Në njërën anë, gratë që morën pjesë në kursin për stërvitje profesionale morrën kurse sesi duhet startuar një biznes.



Vivid presentation at the Business Course in Tetovo

Në vazhdë gratë të cilat nuk morrën pjesë në kursin profesional dhe të cilat do donim të krijonim biznesin e tyre privat u ftuan që të merrnin pjesë. 70 gra mbaruan kursin për biznes. Një javë pasi që mbaroi kursi dhjetë prej tyre vetëm më ishin në etapën e planifikimit për fillimin e biznesit.

### Lidija Milenkovska, Stërvitësi në kursin për biznes në Shkup

*“Në Republikën e Maqedonisë ka shumë gra që punojnë në të zezë. Me qëllim që të jetojmë në një shoqëri të mirë duhet të luftojmë tregjet e zeza. Ne duhet tua themi grave sidomos ato që qepin në shtëpi për shembull, se më mirë është që të kenë biznes legal. Ka shumë përparësi kur flasim për një regjistrim: Së pari, gratë do kenë paga me të gjitha detyrimet sociale. E dyta, do të kenë gjasa për tu pensionuar kur t’ju vijë koha. Gjatë kursit për biznes, synimi im ishte që të shfaq benefitet e zhvillimit dhe fillimit të një biznesi të regjistruar. Synimi im ishte që të kurajojë gratë që të hapin një biznes të ri dhe të bëhen të pavarura nga bashkëshortët.”*



### **Përvoja e menaxheres Esel Msuli së projektit lokal me kurset për stërvitje**

#### **Mund të na raportoni me eciruinë dhe pengasat e këtij projekti ?**

Ne kemi zbatuar shumë projekte por MGPM projekti ishte i pari projekt nga EuropeAid . Në fillim ishte shumë rëndë për ne që të zbatonim procedurat e BE-së të cilat ishin të reja dhe të ndërlikuara. Pas mbarimit të procedurave, ne ia dolëm që të menaxhonim kurset profesionale dhe shërbimin për përkrahje edukative. Pasi që morëm pjesë si mysafirë në stacionet televizive dhe në fund të etapës së parë të kursit profesional u bëmë të famshëm dhe suksesi ynë njihej shumë mirë në komunën e Çairit, Tetovës dhe Radovishit .

Numri i grave që donin të merrnin pjesë në kurset tona përnjëherësh u rrit. Ne madje duhej që të bënim listë të re të grave të cilat do merrnin pjesë në etapën e tretë të projektit. Ne akoma po hulumtojmë për fonde të reja për rundën e ardhshme të kurseve. Jemi bërë disi si brend me logon dhe shërbimet e stërvitjes . Gazetat dhe tv stacionet vazhdimisht na thërrasin për intervista. OJQja jonë ka shumë kërkesa për rekrutimin e vullnetarëve.

#### **Çfarë konsideroni si suksesin tuaj më të madh të projektit?**


Puna që më bëri shumë krenare është fakti se organizata jonë mësoi si punohet si OJQ profesionale. Dokumentimi ynë dhe sistemi arkivor dukshëm është përmirësuar. Për të parën herë OJQja jonë ka mundësinë për të punësuar dhe ka bërë anën më të fuqishme onën burimet jnerzore. Ne, menaxherët e projektit kishim shansin që të shohim në seminare të ndryshme të IBsë për përmirësimin e njohurive tona mbi BE-në dhe menaxhmentin. Shumë gra fituan vende pune! Kjo ishte një tjetër gjë e paqme. Por edhe vizioni i tyre, të cilat nuk kanë gjetur akoma, ka ndryshuar. Ato tashmë duan që të bëhen më aktive në shoqërinë civile dhe duan të punojnë.

## Përcjellja e njohurive

Një nga predispozitat më të rëndësishme për zbatim të suksesshëm dhe për mbarëvajtjen e aktiviteteve stërvitëse janë transferuar dhe janë shkëmbyer njohuri dhe ekspertizë mes partnerëve. Për këto arsye menaxhmenti dhe punishtet stërvitore ishin organizuar herët në projekt. Punishtet për menaxhment synonin që të përcjellin njohuri nga IB-ja deri tek partnerët lokal se si duhet themeluar dhe drejtuar në qendër stërvitjeje. Punishtet tjera për menaxhment dhe stërvitje mbaheshin në mes të projekteve që të sigurohej përfitimi maksimum për kurset për stërvitje si dhe për punën e partnerëve.

Gjatë punishteve për menaxhment stafi lokal i menaxherëve nga të tre organizatat mësoi për metodat më të mira praktike të dokumentimit dhe raportimit, menqaxhimit efikas të detyrave, strategjive të përfshira dhe përmirësimit të bashkëpunimit me aksionerët dhe kompanitë gjatë projektit, dhe metodat për sigurim më kualitativ të monitorimit dhe suksesit të projektit vis a vi zbatimit të qasjes të procesit të vazhdueshëm për përmirësim ( PVP). Punishtja e dytë për menaxhment i dedikohet auditorit të brendshëm në prezencë të menaxherëve gjegjësisht në të tre organizatat. Ky kombinim i auditorit dhe stërvitjes dha rezultate të pëlqyeshme: rezultatet e mësimi, siç ishte dokumentimi i përmirësuar, bëhej gjithmonë e më tepër e dukshme sesa herën e parë të stërvitjes menaxheriale.

Gjatë punishteve për stërvitje stërvitësi pa drejtëpërdrejtë metodologjitë dhe didaktikat e ndryshme të mësimdhënies. Gjatë punishtes së parë fokusi kryesor binte mbi zhvillimin e programit dhe përmbajtjes si dhe mbi vlerësimin të proceseve dhe produkteve. Punishtja e dytë u pregadit në bazë të përvojave dhe problemeve që stërvitësi i pati në mbajtjen e kurseve. Kishte kërkesë të madhe në mes të stërvitësve që të flasin për çështjet motivuese si dhe për përpilimin e dokumentimit të kursit. Së bashku me menaxherët, dokumentimi riorganizohej, si dhe dokumentet po edhe profilizimi i anëtarëve u përmirësua. Veç asaj, mbledhje mbi qëndrueshmërinë u mbajt që të diskutohen sesi stërvitjet profesionale dhe shërbimet për përkrahje mund të vazhdonin edhe pas finansimit. Problemet si përkrahja politike, nevojat financiare dhe pengesat si dhe përkrahja alternative si për shembull partneriteti social me bizneset lokale ishin në agjendë. Ç’do OJQ lokale definoji një plan tentativ për veprim.



## PGKM fakte dhe shifra

Gjatë periudhës së projektit, **415** gratë stërviteshin në tre qytete dhe në tetë vende të ndryshme. Vetëm disa gra nuk ia dolën që të mbarojnë studimet e tyre shkaku i rrethanave familjare. Në total, qendra për stërvitje mbajti **36** kurse për stërvitje.

**193** pjesëmarrëse mbaruan kurse për stërvitje profesionale në

Shkupm, **92** në Radovish dhe fshatrat përreth, dhe **130** pjesëmarrëse vizituan kurset në Tetovë dhe rrethinë. Më shumë se **500** pjesëmarrëse morën pjesë në kurset edukative në të tre lokacionet e projektit.

**32** gra gjetën punë të rregullt, **19** gra tani janë vetëpunësuar dhe **24** planifikojnë startojnë biznes.

Gjatë kursit **129** pjesëmarrëse ishin 15-24 vjeç, **228** 25-49 vjeç dhe vetëm **7** 50- 64 vjeç.

**144** të cilët vizituan kursin kishin arsim të mesëm, **45** kishin arsim të lartë. Sidoqoftë, **70** që kishin vizituar kursin s'kishin arsim aspak, **40** nga ta ishin gra rome dhe **28** ishin gra Turke. **144** kishin vetëm shkollë fillore.

**163** ishin Shqipëtare, **107** Turke, **81** Rome, **34** Boshnjake, **23** Maqedonase dhe **2** Vllehe.

## Rezultate dhe reagimi nga target grupa

Në tërësi, kursi për stërvitje kishte ndikim të dukshëm sidomos atë psikologjik: Studentët e ndryshuan konceptin e tyre për jetën me atë që ka të bëjë me pozitën dhe situatën e punësimit të grave në shoqëri, fituan vetëbesim, si dhe besim në përdorimin efikas të teknologjive moderne. Si rezultat i hulumtimeve të bëra dhe në bashkëbisedimet personale dhe pyetësorët, shumë nga studentët shfaqën dëshirën e tyre për ta ndryshuar jetën për më mirë. Ky është faktori kryesor i cili siguron një vetëkënaqje, realizimin e rëndësisë së kapacitetit dhe potencialit të individit.

Gratë gjithashtu deklaruan një rezultat të konsiderueshëm: afër 97 % e grave u pajtuan se ata kanë mësuar shumë nga kurset. Më shumë se 89 % e grave tani e shohin vehten si të kualifikuara dhe të pregaditura për tregun e punës. Ky është një tregues i cili vërteton se gratë janë të vetëdijshme për aftësitë e tyre dhe kapacitetet dhe nuk kanë frikë që të punësohen. Gati të gjitha gratë tani kanë vullnetin që të aplikojnë për punë.



*Top left: Participants during certificate ceremony in Radoviš, Nov 2013  
Top right: Mayor of Tetovo, Ms Teuta Arifi, awards certificates in Tetovo, Mar 2014  
Bottom left: The two computer trainers with participants during certificate Ceremony in Skopje  
Bottom right: Certificate Ceremony in Skopje, Nov 2013*



*“Unë nuk jam personi i njëjtë që isha, para se të merrja pjesë në këtë kurs..”*

Emine Ibrahim, 23 vjeçe, morri pjesë në kursin për qepje dhe qendisje në Topaanë dhe ka gjetur punë në kompani tekstili në Shkup.

**Çfarë fituat nga ky kurs?**

*Me ndihmën e këtij kursi unë mësova fushat e qepjes dhe qendisjes. Në kurs gjithashtu u vetëdijësova për rëndësinë e punësimit. Gratë të cilat punojnë janë më të emancipuara në shoqëri dhe janë më të pavarura. Me ndihmën e këtij kursi gjeta punë në fabrikë Holandeze të vendosur në Maqedoni. Kjo certifikatë ka shumë rëndësi për mua.*

**Ç’është opiniononi juaj për këto lloj kurse?**

*I këshilloj të gjitha gratë që të marrin pjesë. Nuk i dihet asnjëherë se kur ia del mbanë, në do që të provosh gjëra.*

Zimka Murat, 19 vjeçare, morri pjesë në kursin për rrobaqepësi në Topaanë dhe u punësua në një fabrikë tekstili.

**A ju ndihmoi kursi në vetëdijësimin tuaj për rëndësinë e punës?**

*Po. Kurset më ndihmuan që të vetëdijësohem për punë. Më shumë para për gruan, do të thotë që fiton më shumë pavarësi. Mund t’i risësh njohuritë e tua në shumë fusha.*

**Çfarë ju pëlqeu më së shumti? Përmes kurseve edukative, në të cilat mora pjesë për së pari, e kuptova rëndësinë e të aplikuarit online. Para së gjithash, nuk isha e vetëdijshme për rëndësinë e aplikimit përmes internetit. Çdo grua duhet të ketë njohuri bazike për kompjutorin dhe duhet të ketë e-mail.**

**Këshilla juaj për gratë e papuna**

*I këshilloj gratë të cilat rrijnë në shtëpi që të aplikojnë dhe të marrin kurse dhe të bëhen pjesë e zhvillimit shoqëror.*

Mevluda Culjevik, 37 vjeçare, morri pjesë në kursin për rrobaqepësi në Shkup. Ajo u punësua në një fabrikë tekstili.

**Përse morrët këtë kurs?***Për mua ishte shumë e rëndësishme që të gjeja veten në komunikim me të tjerët. Është mirë që të mësosh diçka. Po të rrija në shtëpi nuk do mësoja gjë. Gjithashtu duhet të kem shans që të njohtoj të tjerë.*

**Mund të ju ndihmojë kursi për rëndësinë e punës?***Po. Jam i kënaqur për njohuritë që kam. Para se të vija këtu, nuk e dija si duken makinat për qepje, as që dija se ç’është interneti. Me njohuritë që kam ia dola të gjej punë. Po të mos fitoja këto njohuri, nuk do kisha shans që të gjeja punë..*

**Ç’i këshilloni gratë e papunësuarat?***Këshilla ime për gratë është që të marrin kurset. Së pari për vete, pastaj për të gjetur punë. Do ndiheni ndryshe atëherë. Unë nuk jam më personi që isha, para se të ndiqja kursin.*

# Sugjerime për mbajtjen e kurseve për stërvitje

## *Analiza e tregut*

Sidomos nëse ofroni stërvitje për klientë që vetë paguajnë, është krusiale që të analizohet thellësisht tregu. Aspektet e ndryshme të cilat ju duhet ti konsideroni janë:

- ✓ Informimi në lidhje me target grupën
- ✓ Të dhënat strukturore për rritjen dhe sektorët ekonomik
- ✓ Analizë të tregut të punës: cilat kualifikime janë të nevojshme? Cili personel i stërvitur është në gadishmëri? Si pritet situata e punës të zhvillohet?
- ✓ Zhvillimi demografik? Si do të rritet popullata? Sa do të zhvillohet target grupa?
- ✓ Konkurrenca. Cilët konkurrentë i keni dhe çfarë shërbimi/ stërvitje ofrojnë ata dhe për çfarë çmimi? Cilat janë kamaret? A ka mungesë shërbimi?

## *Përfitimi i interesit të target grupës*

Sapo keni adresuar situatën e tregut dhe keni vendosur se çfarë shërbimesh dhe stërvitjesh do të ofroni, target grupa duhet të informohet në lidhje me ofertën. Është shumë e rëndësishme që të gjendet një strategji e mirë sesi të fitohet interesi i target grupës:

- ✓ Strategjia për reklamim: vendosja e qëllimeve, definimi i target grupës, vendosja e kanaleve informative dhe medias, vendosja e buxhetit, formulimi i mesazhit
- ✓ Shtypi: konsideroni të mirat dhe të këqijat e shtypit, definimi i agjensioneve dhe kompanive të lajmeve në varësi të qëllimeve
- ✓ Marrëdhëniet publike: zhvillimi i strategjisë së marrëdhënieve publike duke përfshirë evenimente, ditë të hapura, pjesëmarrje në evenimente regjionale, panairë etj, iniciimi i projekteve me institucionet publike duke ftuar mysafirë spikerë.
- ✓ Mediumi i ri: analizoni shfrytëzimin e medias nga target grupa duke përdorur mediat sociale dhe teknologjitë e reja për përfshirjen e target grupës.

## *Motivimi i target grupës*

Sapo të fitoni interesin e target grupës, ata duhet të motivohen që rregullisht të marrin pjesë dhe të mbesin në kurse. Aspektet të cilat duhen marrur parasysh :

- ✓ Karakteristika e target grupit:
  - Cilat janë pikat prekëse të anëtarëve
  - A ka pengesa në pjesëmarrjen e kursit
  - Si është rrethi personal dhe sjellja e përgjithshme e këtij rrethi
  - Cila është sjellja dhe qasja e target grupës
- ✓ Stimulimi i motivimit të brendshëm dhe të jashtëm të studentëve.
- ✓ Vlerësimi i rregullt duke përfshirë pyetësorë mbi motivimin.
- ✓ Për pjesëmarrësit të cilët vizitojnë kursin për aftësi themelore siç është shkrim leximi:
  - Gjeni mënyrën për vlerësimin e pjesëmarrësve
  - Njohja e arsyeve të ndryshme për mungesën e edukimit dhe papunësisë
  - Njohja e performancave të ndryshme të çdo pjesëmarrësi në jetën e përditshme
  - Njohja e aftësive të cilat shfaqen gjatë këtyre performancave.
- ✓ Ofrimi i mësojtoreve për motivimin e pjesëmarrësve .

- ✓ Ofrimi i mundësive për kujdes të fëmijëve për gratë/ pjesëmarrësit.
- ✓ Përcjellja e përvojave studentëve të grupeve të ndryshme me sfond të ngjashëm, si-domos të grave biznismene të cilat planifikojnë të fillojnë biznes.

### ***Menaxhim dhe monitorim efikas***

- ✓ Dokumentimi i saktë i aktiviteteve dhe problemet financiare mund të jenë faktorë kryesorë i suksesit të kursit
- ✓ Është e rëndësishme që të hulumtohet rregullisht tregu i punës dhe të vendoset kërkesa e profesioneve
- ✓ Është e rëndësishme që të intensifikohen kapacitetet ndërtuese të stafit mësues që kanë të bëjnë me stërvitjen e të rriturve dhe të stafit menaxherial që kanë të bëjnë me proceset e sigurimit të kualitetit
- ✓ Programi i kursit për stërvitje profesionale kontribuon dukshëm në progresin e mësimit dhe motivimit për ta aplikuar për punë
- ✓ Që të motivosh gratë e papuna dhe të tërheqësh pjesët e interesuara, është e rëndësishme që të përdoret potenciali i agjensioneve për lajme.

### ***Nëse kurset tuaja finansohen nga Bashkimi European...***

- ✓ Lexo kontratën për Grant me kujdes dhe në detaje
- ✓ Fillo aktivitetet dhe raportimet e finansave në përputhje me rregulloren e BE-së. Përndryshe, fondet e investuara në zbatimin e projektit nuk do të mbulohen.
- ✓ Kujdesu që të gjitha fondet e shpenuara të jenë sipas PRAG udhëzimit
- ✓ Sigurohu që rregullat e BE-së dhe udhëzimet mbi transparencën të përmbahen në CVMEEA
- ✓ Mos ngurro që të pyesësh zyrtarin vëzhgues të CA-së për këshilla dhe ndihma në administrimin dhe zbatimin e projektit tuaj
- ✓ Prezento vëzhgim sistematik dhe sistem vlerësimi si dhe përdori ato që të përmirësosh aktivitetin dhe rezultatet tuaja
- ✓ Mbaj shënime mbi çdo aktivitet dhe korespondencë me donatorët dhe CA-në
- ✓ Bëju gati për vizita vëzhguesish nga CA-ja. Mundohu që ti kesh të gjitha dokumentet relevante në dorë.

## Të aplikuarit për fonde të Bashkimit European

Ka disa mundësi për të aplikuar për fonde Europiane në fushën e edukimit dhe stërvitjes. Tani ka tre mekanizma të ndryshme të finansimit: IPA ndër drejtorinë gjenerale të komisionit European për zgjerim, programat tematike ndër DG për bashkëpunim dhe zhvillim, dhe programet të ndryshme për komunitetet si P.SH ERASMUS+ në fushën e edukimit dhe stërvitjes. Delegacioni i BE-së në Maqedoni jep informata për mundësitë e tenderit në webpage: [http://eeas.europa.eu/delegations/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia-/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia-/index_en.htm).

Nëse planifikon të aplikosh për finansim, lutja duhet të dizajnohet dhe elaborohet në mënyrën më të mirë të mundshme:

### Hapi 1: Gjej mundësitë e finansimit!

#### Hulumtimi mbi mundësitë e finansimit

- ✓ Mbaj hulumtime të rregullta javore për thirrje të reja, kontrollo ueb faqet e BE-së mbi finansat dhe rishiko dokumentet kyçe të programeve për çdo lloj azhurimi
- ✓ Vizito evenimente në rrjet dhe konferenca që të jesh në kontakt me aksionerët dhe organizatat tjera aktive në të njëjtën fushë. Kjo do të ndihmojë që të jesh në trend me mundësitë e finansimit dhe të kesh lajmet më të reja dhe zhvillimet, por gjithashtu dhe për rangun e stërvitësve dhe konkurrencës tënde.

### Hapi 2: Gjeji nevojat e target grupës tënde !

#### Pregaditje

- ✓ Shiko nëse organizata juaj ka kapacitet që të fiton dhe menaxhon me grantin
- ✓ Dizajno projekt i cili i shërben nevojave të target komunitetit dhe organizatës tuaj
- ✓ Shfrytëzo statistikat zyrtare , raportimet, publikimet dhe punimet shkencore që të mbledhësh informata të sakta dhe të vlefshme për punën që ke ndërmend ta bësh.

### Hapi 3: Formo një partneritet produktiv dhe solid!

#### Aksionerët dhe partnerët

- ✓ Bëj analizë të aksionerëve dhe mbëlesh mendimet dhe këshillat e tyre. Mundohu të krijosh aleanca që do të të përkrahin sapo projekti të jetë zbatuar
- ✓ Nëse projekti juaj kërkon partneritet në projekt, investo kohën e duhur në gjetjen e organizatës partnere të duhur sa më shpejtë.
- ✓ Sigurohu se partnerët e tu i plotësojnë kushtet e definuara sipas udhëzuesit
- ✓ Ndërto partneritet projekti solid në suaza të projektit si dhe me aksionerët dhe me bashkëpunëtorët përreth
- ✓ Nëse ke mundësi takohu me partnerët e tu parak kohe ose përdor metoda alternative si Skype që të diskutosh për projektin
- ✓ Transparenca në çështjet administrative dhe finansiare është jetike!

### Hapi 4: Skico një kon- cept të shën- doshë!

#### Skica dhe korniza logjike e projektit

- ✓ Zhvillo një matricë të kornizës logjike para se të shkruashësh propozimin e projektit. Në EuropeAid thirrjet është e obligueshme që të dorëzohet korniza logjike si aneks për propozimin e projektit. Në fakt korniza logjike është vegël efikase për të strukturuar qëllimet e tua dhe idetë si dhe për të kontrolluar logjikën dhe konzistencën si të indikatorëve të skicës të cilët mund ti përdorësh më pastaj për të vëzhguar progresin drejtë qëllimeve. Një kornizë logjike kualitative duhet të jetë pika fillestare e dizajnit tënd të projektit
- ✓ Shih nëse aktivitetet janë direkt të lidhura me synimin për arritjen e rezultateve të pritura. Testo kornizën logjike që të shohësh nëse është me të vërtetë logjike
- ✓ Përfshij partnerë dhe personelë ku do shkruash kornizën logjike dhe kërko këshilla nga jashtë për ta parë atë.
- ✓ Lexo udhëzuesit dhe dokumentet tjera me kujdes. Mos lë anash asnjë detaj. Përshtat konceptin dhe kornizën logjike tënde me qëllimet në udhëzues.
- ✓ Shkruaj një skicë të projektit duke nënvizuar qëllimet dhe aktivitetet e planifikuara, dhe prezentoji ato te partnerët dhe bashkëpunëtorët.
- ✓ Nëse ke nevojë për udhëzime dhe materijale stërvitëse sesi të zhvillosh një projekt, mund të vizitosh : [http://ec.europa.eu/europeaid/-multimedia/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europeaid/-multimedia/index_en.htm)



### Hapi 5: Dizajno një propozim pro- jekt të sukses- shëm !

#### Propozim projekti

- ✓ Suksesi i përfundimit të plotë të propozim projektit është më pak i komplikuar, sapo të kesh dizenuar një kornizë logjike të shëndoshë dhe ke mbëledhur dhe analizuar të dhënat e dnr-shme.
- ✓ Sigurohu se ke mbëledhur të gjitha dokumentet e nevojshme për organizatën tuaj dhe partnerët sa më shpejtë.
- ✓ Mos tejkaloni numrin maksimum të shenjave ose faqeve që lejohen!
- ✓ Përfundo çdo pjesë të aplikimit sipas udhëzimeve të dhëna
- ✓ Vëzhgo me kujdes udhëzimet që kanë të bëjnë me afatet dhe dokumentet të cilat duhet të dorëzohen.
- ✓ Konsidero me kujdes procedurat e zgjedhura dhe kriteriumet për vlerësim të cilat zakonisht janë të shënuara në udhëzuesin!

### Hapi 6: Rregullo bux- hetin!

#### Formimi i buxhetit

- ✓ Kujdesi i veçantë duhet pasur gjatë formimit të buxhetit duke pasur në konsideratë legjislacionin tatimor dhe të punës në Republikën e Maqedonisë
- ✓ Mundohu të kuptosh konceptet e buxhetit, vëzhgo me kujdes udhëzuesit për buxhetin dhe sigurohu që të mos vësh në pah gjërat që nuk plotësojnë kushtet
- ✓ Është esenciale që të bësh njehsimet saktë. Nëse kalkulimet tua janë shumë lartë mund të mos fitosh grantin; Nëse kalkulon pak, mund të mos mbulosh finansat tua. Vëzhgo me vëmendje harxhimet për realizimin e aktiviteteve të projektit tënd.
- ✓ Krijë një plan të harxhimeve të detajuar dhe real bashkë me partnerët e tu
- ✓ Mbulo të gjitha shpenzimet reale në kalkulimet e tua përfshirë këtu harxhimet e punës së dorës, menaxhmentit dhe harxhimet administrative, harxhimet për materijale ,pajisje, qirasë dhe harxhimet e transportit. Duhet të kesh internet, rrymë, ujë dhe harxhimet e nxehtësie në konsideratë.
- ✓ Përfshij kalkulimet indirekte të harxhimeve. Këto mund të jenë kalkulime të rënda, por duhet të jesh i vëmendshëm për to dhe ti faktorizosh në buxhetin tënd.
- ✓ Mos delego kompetenca kyçe.



### ***The European Union***

*The European Union is made up of 28 Member States who have decided to gradually link together their know-how, resources and destinies. Together, during a period of enlargement of 50 years, they have built a zone of stability, democracy and sustainable development whilst maintaining cultural diversity, tolerance and individual freedoms. The European Union is committed to sharing its achievements and its values with countries and peoples beyond its borders. The European Commission is the EU's executive body.*



This project was implemented  
by Internationaler Bund (IB) and partners